

VENDIM
Nr. 11, datë 7.1.2005

**PËR DHËNIE FONDI BUXHETOR KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR SI NDIHMË
FINANCIARE PËR VENDET E AZISË JUGLINDORE, TË CILA JANË PREKUR NGA
TSUNAMI, SI DHE PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE TË VETA, PËR
PËRBALLIMIN E SITUATAVE TË EMERGJENCAVE CIVILE APO FATKEQËSIVE
NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryqit të Kuq Shqiptar, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, t’i jepet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) dollarësh amerikanë, kontribut i qeverisë shqiptare, si ndihmë humanitare për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tsunami, që goditi brigjet e vendeve të Azisë Juglindore, si dhe për forcimin e kapaciteteve të veta, për përballimin e situatave të emergjencave civile apo fatkeqësive natyrore.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano